

VENDIM
Nr.495, datë 15.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Fjala e parë e shkronjës “a” të pikës 3 “Buletini i Njoftimeve Publike”, të kreut I “Organizimi i prokurimit publik”, në tekstin e rregullave të prokurimit publik, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“APP-ja boton çdo ditë të hënë Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në çdo rast tjetër, me vendim të drejtorit të APP-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha